



RELACION TEKNIK

*KALIMI NGA 10KV NE 20KV TE
KABINES "SHKOLLA KONGRESI
MANASTIRIT"*

Tiranë

HYRJE

Referuar strategjisë së zhvillimit dhe përmirësimit të rrjetave elektrike që ka kompania OSHEE, ndër të tjera është dhe zhvillimi i rrjetave të reja 20 kV si dhe eliminimi i rrjetave të vjetra ajror dhe kthimi i tyre në kabllor.

Në vitet e fundit në sistemin e Shpërndarjes janë kryer investime domethënëse, në pajtueshmëri me objektivat dhe synimet e identifikuara nga planifikimi afatgjatë zhvillimor i sistemit të Shpërndarjes.

Nisur nga sa më lart si dhe duke u mbështetur në kërkesat e njësive mbi problematikat që hasen më shpesh në rrjet, si pasojë e defekteve në linjë, lind nevoja për përmirësimin dhe ndërhyrjet në zonat ku shfaqen këto problematika.

Konkretisht në këtë relacion do të shqyrtojmë përmirësimin e një pjese të zones e cila mbulohet nga fideri ajror 25/10 kV N/St Selite.

Objektivat specifike kanë të bëjnë me:

- ❖ Eliminimin e rrjetit ajror që është jashtë kushteve teknike.
- ❖ Eliminimin e rrjetit ajror në zonat ku ka intensitet zhvillimi urban.
- ❖ Zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes TM 20 kV duke respektuar standarte conform kushteve teknike.
- ❖ Zvogëlimi i humbjeve teknike në nivelin e lejuar sipas standardeve teknike
- ❖ Rritja e cilësisë së furnizimit për abonentet fundorë, duke ulur kohën e ndërprerjes dhe pasjen e një tensioni të stabilizuar.

GJËNDJA EKZISTUESE E RRJETIT

Kjo zonë aktualisht furnizohen nga fideri 23, 10 kV N/Stacioni Selite 110/20/10kV.

Rrjeti ekzistues është 80 % ajror, i amortizuar, i ndërtuar para shumë vitesh, ndaj lind nevoja e zhvillimit të zonës dhe përmiresimin e furnizimit me energji elektrike të zonave.

Gjendja aktuale e infrastructures elektrike të zones ne fjalë (në rrjetin shpërndarës të TM) paraqitet jashtë kushteve teknike dhe e ekspozuar ndaj ndikimit të kushteve atmosferike, gjë që sjell kufizime dhe cilësi të ulët në furnizimin me energji elektrike të përdoruesëve të kësaj zone.



Zona e rruges 3 Deshmoret perreth kabines Shkolla Kongresi Manastirit furnizohet nga kabina ajrore B. Agolli 250 kVA, e cila eshte shume e ngarkuar.

Per kete arsye eshte e nevojshme rikonstruksioni kabines Shkolla Kongresi Manastirit, kalimi i saj nga 6kV ne rrjetin 20kV.



QËLLIMI

Ky projekt konsiston në permisimin e furnizimit me energji elektrike te zones se Rruges 3 Deshmoret, Shkolles Kongresi Manastirit e cila per shka se punon me turne eshte e nevojshme furnizimi me energji elektrike te pa nderprere.

Do te behet kalimi i kabines Shkolles Kongresi Manastiritnga rrjeti 10kV ne 20kV ne fiderin F16, N/St.Kashar 110/20kV.

Do te behet dhe rikonstruksioni i rrjetit TU me kabell ABC dhe rishperndarja e ngarkeses.

Kabina Shkolles Kongresi Manastirit 20kV do te kete trasformator 400/20/0.4kVA, furnizimi i kabines do te behet nga fideri 20 kV F16 N/St.Kashar.

- Objektivi i këtij projekti është ulja e humbjeve teknike në rrjetin TM/TU, rriten standartet e cilësisë së furnizimit me energji elektrike në përputhje me kodin e shpërndarjes, si niveli i tensionit numri i ndërprerjeve nga difektet
- Projekti do të rrisë sigurinë e furnizimit me energji elektrike të abonentëve pasi rrjeti 20kV ka ndikim minimal nga kushtet atmosferike.

MBROJTA DHE SIGURIA E PUNONJËSVE QË DO KRYEJNË PUNIMET.

Të gjithë punonjësit që do të jenë pjesë e punimeve të zbatimit, duhet të jenë të pajisur me formimin e duhur, për marrjen e masave paraprake të sigurisë në punë, përfshirë dhe masat e nevojshme për të parandaluar rreziqet për njerëzit e tjerë dhe objekteve të tjera.

Për të gjithë punonjësit që do të kryejnë punime pranë paisjeve apo linjave elektrike me dhe pa tension duhet të jenë të pajisur me veshjet, mjetet dhe veglat e nevojshme si dhe me kategoritë përkatëse të njohjes dhe zbatimit të rregullores dhe shfrytëzimit teknik.

Të gjithë punonjësit të jenë të pajisur me grupin e kualifikimit të dhënë nga Inspektoriati Qëndror i Sigurimit Teknik për vitin aktual.